



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Punëve të Brendshme-Ministarstvo Unutrašnjih Poslova-Ministry of Internal Affairs

Akademia e Kosovës për Siguri Publike/Kosovska Akademija za Javnu Bezbednost
Kosovo Academy for Public Safety

Në mbështetje të Ligjit Nr.03/L-212 i Punes, Udhëzimit Administrativ Nr.14/2011 për rregullimin e procedurave për themelimin e marrëdhënies së punës në sektorin publik, si dhe Udhëzimin Administrativ (MPMS) Nr.05/2014 për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr.14/2011 për rregullimin e procedurave për themelimin e marrëdhënies së punës në sektorin publik, **Akademia e Kosovës për Siguri Publike**, shpall këtë:

KONKURS
për plotësimin e vendit të punës

I.

Pozita:	Teknik i Mirëmbajtjes/Ngrohtores
Nr. i references:	AKSP-2/2017
Numri i vendeve të punës:	1 (një)
Koeficienti:	5.5
Orari i punes:	I plotë

Detyrat dhe përgjegjësit kryesore

1. Siguron nivel të larte të funksionimit të sistemit të furnizimit me ujë të ngrohtë dhe sistemin e ngrohjes në ndërtesat e AKSP-së;
2. Kryen kontrollet ditore të sistemit të ngrohjes duke përfshirë riparimet apo ndërrimet e pajisjeve të dëmtuara, si: radiatorët, valvulat, kokat termike, tubat, etj.;
3. Siguron riparimet e vogla dhe aranzhon riparimet e madhore të kaldajave, rezervuarëve, pompave, qilarëve, njësive për ngrohje te ajrit, etj.
4. Është përgjegjës për mbajtjen në nivel të duhur të presionit të avullit të nivelit të lendes djegëse në rezervuar dhe të mbaj shënime lidhur me sasinë e lendes djegëse që shpenzohen dhe sasinë aktuale në rezervuar;
5. Kontrollon stabilimentet e kaldajave për shkak të nivelit të sigurisë që të mos vije deri të një avari e mundshme;

6. Benë inspektimin ditor, i cili duhet të jetë i një standardi të lartë profesional, sa i përket funksionimit të të gjitha instalimeve për ngrohje;
7. Kryen edhe detyra tjera në përputhje me legjislacionin e aplikueshëm e që kërkohen kohë pas kohe nga Udhëheqësi i Divizionit të Shërbimeve të Përbashkëta.

Shkollimi dhe përvoja e kërkuar

- Diploma e shkollës së mesme (e obligueshme).
- Njohja e njërës nga gjuhët zyrtare (e obligueshme).
- Se paku një (1) vite përvojë relevante profesionale (e preferueshme).

Aftësia, dhe atributet tjera që kërkohen

Fleksibilitet dhe aftësi për të punuar nën presion dhe brenda afateve të kufizuara kohore, aftësi për të punuar me njerëz të kulturave dhe religjioneve të ndryshme, gjinisë dhe pikëpamjeve të ndryshme politike duke ruajtur paanshmërinë dhe objektivitetin, vet-iniciativë dhe përkushtim i vëmendjes ndaj detaleve dhe aftësi për të punuar në një ambient ekipor.

Kohëzgjatja e emërimit

Konform Ligjit të Punës Nr.03/L-212. Periudha provuese gjashtë (6) muaj.

Data e mbylljes së konkursit

Konkursi është i hapur 15 ditë kalendarike nga data e publikimit, duke filluar nga data 24.04.2017 deri me datën 08.05.2017, në ora 16:00.

Paraqitja e kërkesave

Aplikacionet dorëzohen në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike në Vushtrri, në Zyrën e Personelit. Kandidatet e interesuar aplikacionin mund ta shkarkojnë në adresën elektronike: <http://aksp.rks-gov.net/>. Aplikacionit i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin, përvojën dhe dokumentacionet tjera të nevojshme që kërkohet për vendin e punës për të cilin konkurrioni.

“Akademia e Kosovës për Siguri Publike ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë”.

Kërkesat e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Kërkesat e pakompletuara mund të refuzohen.

Për shkak të numrit të madh të kërkesave të pranuar, vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.

Për informata me të hollësishme mund të kontaktoni Zyrën e Personelit nr. tel: 028 590 070 ext 210 ose 211, prej orës 08:00 - 1600.